

ARE përfshinte tri shtylla: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, konkurrencën dhe klimën e investimeve, si dhe arsimin dhe punësimin, me 22 masa të shpërndara në tri shtylla, të gjitha të parapara për t'u zbatuar nga institucionet përgjegjëse në fund të vitit 2017. Ky dokument i politikave është dizajnuar për të qenë në përputhje me Programin e Reformës Ekonomike të Kosovës, dokumentin kryesor të politikave ekonomike që udhëheq dialogun ekonomik me BE-në. Megjithatë, ky dokument do të duhej të ishte në përputhje me programin qeveritar që rëndom ndryshon varësisht prej partive politike që marrin pushtetin dhe formojnë qeverinë. Me këtë parasysh,

ARE duhet të jetë në linjë me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit - dokumentin kryesor të politikës - me qëllim që ta rris nivelin e zbatimit. Qeveria Mustafa u zotua t'i përmbushte këto masa brenda një periudhe njëvjeçare në përputhje me planin e veprimit; megjithatë, këto prioritetet nuk u zbatuan në vitin 2020, deri në kohën e shkrimit të kësaj analize.

Nga ana tjetër, pas ndryshimit të qeverisë në shtator 2017, u adoptua ARE tjetër; qeveria Haradinaj miratoi të ashtuquajturën ARE II.4 Ndryshe nga ARE, ky dokument u miratua në mënyrë të njëanshme pa konsultime paraprake me Komisionin. Rrjedhimisht, dokumenti krijoi paqartësi në mesin e administratës publike dhe shoqërisë civile në kontekst të asaj se cili dokument duhet t'u shërbente si kryekorniza udhëzuese. Për më tej, erdhi një tjetër qeveri e re në pushtet më 2020 dhe, megjithëse nuk janë zbatuar të gjitha masat nga ARE ose e ashtuquajtura ARE II, një ARE II e re u miratua në tetor 2020.